



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.19/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushë Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.238/2023, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira, Burbuqe Spahija Kërveshi, Përmbaruesi Privat dhe në mungesë të përfaqësuesit të Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Përmbarueseve Privat, të ftuar me rregull për seancë, me datë 09.12.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira, DPSDPLS-19/2024 i datës 22.10.2024, dhe raporti i Ministrisë së Drejtësisë - Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Përmbarueseve Privat i datës 22.10.2022, **si të pa bazuara.**

II. Përmbareuesi Privat si organ përmbareues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbareimore P. nr. 238/2023.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2024, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Përmbareueseve Privat, në Ministrinë e Drejtësisë, ka paraqitur raportin, nr.11/2024, me të cilin pretendoi se përmbareuesi privat, ka bërë shkelje pasi përmbareimi është lejuar në bazë të faturave, të cilat kanë qenë kopje dhe jo në origjinal ose kopje të vërtetuara nga origjinali, më të cilin veprim e ka pamundësuar realizimin e kërkesës së kreditorit.

Përmbareuesi nuk ka ofruar përgjigje në ankesë, por në seancën e datës 09.12.2024, komisionit i ka ofruar përgjigjen që i ka dhënë zyrtares së ministrisë me rastin e inspektimit të punës së tij, për këtë rast. Sipas përgjigjes, përmbareuesi ka potencuar se lejimi është bërë mbi bazë të faturave origjinale, që janë ofruar në momentin e parashtrimit të propozimit që edhe i ka lejuar dhe se përmbareuesi i ka sugjeruar palës kreditore që të bëjë kopje dhe të i vërtetoj të njëjtat për arsye të vet palës kreditore. Por pasi ka ardhur, pala kreditore ka kërkuar faturat që janë dorëzuar tek përmbareuesi dhe përmbareuesi ka konstatuar se dikush nga stafi i përmbareuesit kur ka bërë ekspedimin e urdhrin , gabimisht ka ekspeduar tek debitori faturat në origjinal.

Baza ligjore që një përmbareues privat mund të bëjë shkelje disiplinore

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbareimore, i përcakton shkeljet përmbareimore për përmbareuesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbareuesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbareuesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbareuesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbareuesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbareuesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbareuesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbareuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbareuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;

- 1.9. Nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lart cituar, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim që Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Nuk është kontestuese se në mes te palëve në procedurë dhe për komisionin disiplinor, se Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbarim Privat, për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, për Përmbaruesit Privat nga Ministria e Drejtësisë, ka bërë inspektimin e veçantë të punës, për këtë çështje juridike.

Nuk është kontestuese poashtu se përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës.

Kontestuese mbetet në këtë rast, se a kemi të bëjmë me shkelje disiplinore, pasi që përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të faturave kopje.

Komisioni Disiplinor pas analizimit të dispozitës së lartcekur ligjore, erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike nuk kemi të bëjmë me shkelje disiplinore, por kemi të bëjmë me një nga shkaqet e paraqitjes së prapësimit sepse siç dihet dhe siç është e përcaktuar me LPP, ligjshmëria e lejimit të përmbarimit të përmbaruesit, i nënshtrohet ligjshmërisë sipas prapësimit në gjykatë, bazuar në nenin 71,pika 1.12 të LPP-së. Andaj komisioni në këtë procedurë e ka vlerësuar çështjen vetëm të kërkesës për çështje disiplinore, që për komisionin përmbaruesi nuk është përgjegjës, ngase nuk është lëshuar në ekzaminimin e kërkesës së inicuesit të kësaj procedure, pasi që rasti ka të bëjë me shkeljen eventuale të kompetencës lëndore, e që nuk është në juridiksionin e këtij komisioni që ta vlerëson ligjshmërinë e vendimit të përmbaruesit, ashtu siç u vlerësua më lart.

Andaj, me këtë rast komisioni vlerësoi së përmbaruesi në fjalë, nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbarimore për rastin të cilin është paraqitur ankesa, janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr.19/2024 datë 09.12.2024

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ, bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.